LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJI

RAPORTI TREMUJOR 11



THEKSOHEN PËRPARIMI I MADH DHE ANGAZHIMI I PËRBASHKËT GJATË TAKIMIT TË GJASHTË TË BORDIT UDHËHEQËS

KONFERENCA "TRANSPARENCA SI FAKTOR THELBËSOR NË PUNËN E KËSHILLIT TË PROKURORËVE PUBLIKË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT"

"KAFE ME NJË QËLLIM TË QARTË" – BURRAT ANGAZHOHEN PËR BARAZINË GJINORE

NË MAQEDONINË E VERIUT FILLON FUSHATA PËR LOBIM TRANSPARENT DHE LIGJOR

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

MAJ 2026

KY RAPORT U FINANCUA NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISH PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PARATHËNIE



Diter SHINDLAUER

Udhëheqës Ekipi, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

"Po e shfrytëzojmë këtë botim që të vazhdojmë të mbajmë lartë moralin dhe etikën e besimit në një arsye të shëndoshë për ndryshim, reforma dhe proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për të bërë këtë, do të flasim mbi hapat e bëra përpara dhe do të festojmë për to në mënyrë që të mos humbasin në lajmet jo aq pozitive që janë gjithmonë më të zëshme."

I dashur lexues,

Ky raport tremujori i trembëdhjeti me radhë vjen në një moment shumë të rëndësishëm për projektin tonë. Tashmë po zbatojmë këtë projekt për tri vite me radhë. Bashkëpunimi me të gjithë përfituesit ka marrë formën e plotë, është testuar, dhe aktivitetet po ecin si një makinë që shkon shpejt. Pa dyshim që edhe ky raport ritregon sukseset e ngjarjeve dhe aktiviteteve si dhe fushatave për rritjen e vetëdijes që përfshijnë opinionin e gjerë. Jo gjithmonë duhet të prezantojmë ato ngjarje që duken. Për mua, ka disa rreshta në këtë raport që të ngrohin zemrën. Në faqen 17 tregohet historia e stafit të kopshteve, shkollave fillore dhe të mesme të cilët pas pjesëmarrjes në punëtoritë organizuar nga projekti ynë filluan të ndajnë njohuritë dhe aftësitë me kolegët dhe palët e tjera relevante me vetëiniciativë. Këtë gjë e bëjnë mbi një çështje shumë të komplikuar: parandalimi i ngacmimit seksual të fëmijëve. Kjo pra është edhe tema për të cilën ne filluam fushatën tonë publike, ndjekur nga punëtori tematike, dhe tashmë po shohim ndryshime institucionale—me iniciativë nga profesionistë të dedikuar. Kjo gjë është shumë inkurajuese!

Gjatë kësaj periudhe raportimi kishim edhe shumë aktivitete të tjera pozitive: një fushatë e suksesshme për rritje të vetëdijes mbi lobimin, një temë për të cilën akoma nuk ka shumë njohuri apo që vazhdon të keqkuptohet;

PARATHËNIE

punëtori të çmuara për autoritetet që janë në linjën e parë kur bëhet fjalë për dhunën me bazë gjinore, që poashtu u fokusua edhe në mirëqenien e tyre; analizë ku theksohet rëndësia e rritjes së aktiviteteve kundër ngacmimit seksual të fëmijëve; ngjarje me pjesëmarrje të lartë mbi rolin që kanë burrat në forcimin e barazisë gjinore, si dhe takimi i Bordit Udhëheqës i Projektit tonë.

Poashtu mund të lexoni një intervistë interesante mbi rolin e Agjencisë së Menaxhimit me Pronat e Konfiskuara.

Një tjetër fokus gjatë kësaj periudhe iu dha çështjeve që lidhen me transparencën dhe komunikimin institucional. U zhvilluan diskutime lidhur me mënyrat se si gjyqësori, prokuroria publike dhe Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit mund të komunikojnë në mënyrë efektive me opinionin në mënyrë transparente. Poashtu u hartuan strategji për të rritur komunikimin. Të gjithë ranë dakord që besimi publik varet nga komunikimi i drejtë dhe transparent dhe nga mënyrat e besueshme të arsyetimit dhe shpjegimit të vendimeve apo zhvillimeve. Të gjitha këto duken si gjëra të lehta me fjalë por jo aq të lehta në vepër. Prandaj, jam shumë krenar që projekti ynë ia doli të ofrojë mbështetjen e nevojshme që këto angazhime të japin rezultate praktike.

Në këtë raport ka edhe shumë gjëra të tjera për tu zbuluar, prandaj jua rekomandoj ta lexoni me kënaqësi. Mbani kend që ky raport përbën një antidotë për çdo lajm të keq dhe për çdo qëndrim pesimist. Ka përparim; populli është aktiv, dhe sfidat pranohen dhe trajtohen me dedikim.

Shijoni lajmet e mira!



Diter Shindlauer
Udhëheqës i Ekipit

JU PREZANTOJMË:

FILLON NË MAQEDONINË E VERIUT FUSHATA PËR LOBIM TRANSPARENT DHE LIGJOR

Në bashkëpunim me KSHPK, filloi fushata ,,Lobimi në Maqedoninë e Veriut". Qëllimi që duam të arrijmë me këtë fushatë është rritja e vetëdijes së opinionit mbi rëndësinë që ka lobimi transparent dhe ligjor dhe të informojmë dhe edukojmë opinionin mbi rolin që ka lobimi në proceset demokratike.

"TË PIMË NJË KAFE ME NJË QËLLIM TË QARTË" – BURRAT ANGAZHOHEN PËR BARAZINË GJINORE

Forumi i të Drejtave të Njeriut bëri bashkë palët më të rëndësishme relevante për të eksploruar barazinë gjinore nga perspektiva e meshkujve. 50% e pjesëmarrësve ishin burra, gjë që theksoi rëndësinë që ka angazhimi i burrave për këtë çështje.

TRANSPARENCA SI FAKTOR THELBËSOR NË PUNËN E KËSHILLIT TË PROKURORËVE PUBLIKË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kjo konferencë vjen si rezultat i hapave të mëparshme pas miratimit të Strategjisë së Komunikimit dhe Transparencës dhe Rregullores mbi Mbrojtjen e Prokurorëve Publikë nga Ndikimet e Padëshiruara.

Të flasim pak për...

- Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit: Theksohen përparimi i madh dhe angazhimi i përbashkët gjatë Takimit të gjashtë të Bordit Udhëheqës
- Analiza zbulon 604 raste të ngacmimit seksual të fëmijëve gjatë 6 viteve dhe zbrazëtirat ekzistuese në mbrojtjen e viktimave
- Fillon në Maqedoninë e Veriut fushata për lobim transparent dhe ligjor
- Trajtuesit e parë të DHBGJ nga Qendrat e Punës Sociale: Nga forcimi i përgjigjes ndaj thirrjeve të viktimave deri tek përkujdesi për qëndrueshmërinë e tyre
- Konferenca ,,Transparenca si faktor thelbësor në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut"
- Forcimi i gjyqësorit dhe prokurorisë publike përmes komunikimit transparent
- ,,Kafe me një qëllim të qartë" – Burrat angazhohen për barazinë gjinore
- Forcimi i transparencës dhe besimit publik: Mbështetja e KSHPK në ndërtimin e komunikimit strategjik
- Organizimi i punëtorive për parandalim të ngacmimit seksual të fëmijëve
- Intervistë me Arita Haxhievën: Ndërtimi i një sistemi modern për menaxhimin me pronat e konfiskuara në përputhje me standardet e BE-së

Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit: Theksohen përparimi i madh dhe angazhimi i përbashkët gjatë Takimit të gjashtë të Bordit Udhëheqës

Projekti Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit mbajti Takimin e Gjashtë të Bordit Udhëheqës në 26 mars 2026 në hapësirat e Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK). Ky takim kishte në fokus prezantimin e rezultateve të projektit nga gushti 2025 deri në shkurt 2026 dhe theksimin e hapave të ardhshme.

Udhëheqësi i Ekipit, Z. Diter Shindlauer, hapi takimin dhe u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, duke ftuar Z. Adem Çuçul, Kryetarin e KSHPK t'i drejtohet të pranishmëve. Z. Çuçul shprehu kënaqësinë për organizimin e takimit dhe theksoi përfitimet e mëdha që KSHPK ka pasur nga ky projekt. Ai theksoi që në të ardhmen i duhet kushtuar më shumë vëmendje fushës së lobimit si një fushë që është e rëndësishme por nuk trajtohet mjaftueshëm dhe në këtë drejtim mirëpriti mbështetjen që ofrohet brenda Komponentit 3.



Znj. Marzia Palota, Atashe në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut, ritheksoi mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për pranimin e vendit në BE. Ajo theksoi që reformat për sundimin e ligjit janë thelbësore për procesin e zgjerimit dhe do të caktojnë rrugën e pranimit. Ajo inkurajoi palët relevante të shfrytëzojnë këtë projekt në mënyrë strategjike, të mbajnë koordinim të fuqishëm dhe të fokusohen në arritje të rezultateve konkrete.

Znj. Agnes Taibl, Drejtoreshë e Projektit nga Instituti Ludvig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Drejtave të Njeriut, falenderoi KSHPK për mirëpritje të këtij takimi dhe theksoi që ky projekt po futet në fazën përfundimtare, që pritet të mbarojë në nëntor. Ajo theksoi rëndësinë që ka zbatimi intenziv dhe planifikimi i të ardhmes, përfshirë këtu vlerësimin vijues të ndikimit për të parë rezultatet në nivel individual, organizativ dhe sistemor. Ajo theksoi që vlerësimi është një mjet i rëndësishëm për të parë sukseset, sfidat dhe mundësitë për qëndrueshmëri, dhe shprehu falenderimet për çdo partner dhe përfitues për bashkëpunimin e ofruar.

Gjatë kësaj periudhe raportimi ky projekt ka arritur përparim të dukshëm në që të gjitha katër komponentet.







Me Komponentin 1 u forcua gjyqësori me përparim të strategjisë për burime njerëzore dhe me përkufizim të një udhëzuesi për përmirësim të saj. Në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorëve Publikë dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë u rrit transparenca përmes një strategjie të re komunikimi, u mbështet dixhitalizimi në pesë institucione, dhe u ofruan trajnime për IT për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Poashtu përfundoi shqyrtimi gjashtëmujor i planit të veprimit për Ministrinë e Drejtësisë.



Me Komponentin 2 u forcuan kapacitetet e Ministrisë së Brendshme përmes trajnimeve të targetuara për inteligjencën e krimeve, hetimeve financiare, krimet që lidhen me drogën, dhe anti-korrupsion. Këto aktivitete përfshijnë punëtoritë e specializuara mbi OSINT dhe kripto-valutat si dhe ushtrimet për anti-terrorizëm. Sektori për Operacione të Fshehta vazhdoi forcimin e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe këmbimeve mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, kurse një punëtori e nivelit të lartë mbi reformat policore mbështeti rritjen e koordinimit dhe efikasitetin organizativ.



Brenda Komponentit 3 u dëshmuan rezultate të mira në bashkëpunim me KSHPK, përfshirë këtu përfundimin e Strategjisë ICT dhe përpilimin e dokumenteve thelbësore për komunikim. Përparim u pa edhe në forcimin e sistemit për deklarim të pasurive dhe digjitalizimin e tij, kurse mbështetje u ofrua edhe për përpilimin e Strategjisë Kombëtare Anti-korrupsion 2026–2030. Aktivitete të tjera ishin edhe trajnimet mbi pronat kripto dhe analizën e të dhënave, si dhe përgatitja e trajnimit anti-korrupsion dhe fushatës për rritje të vetëdijes së opinionit mbi lobimin.



Me Komponentin 4 u forcuan kapacitetet për të drejtat e njeriut dhe kapacitetet profesionale në shumë institucione, me trajnim të rreth 600 profesionistëve dhe duke ndikuar tek 100 000 individë me fushata për rritje të vetëdijes. Kjo bëri që të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional përmes qasjes që merr parasysh të drejtat e njeriut, të mbështeten rritja e mbrojtjes së viktimave, te kontribohet drejt reformave ligjore për mbrojtje të fëmijëve dhe të avancohet shërbimi i provës, duke tejkaluar qëllimet e planifikuara dhe plotësimin e parakohshëm të tyre.



Përfaqësuesit e institucioneve partnere shprehën falenderimet e tyre për mbështetjen e vazhdueshme që marrin nga projekti dhe kontributin që projekti jep ndaj forcimit të sundimit të ligjit.
Me këtë takim ku morën pjese 43 përfaqësues nga Delegacioni i BE-së, partnerët e konsorciumit, institucionet përfituese, dhe ekspertë, u ritheksua angazhimi i përbashkët për të ndërtuar shoqëri më të drejtë dhe më transparente në Maqedoninë e Veriut.



Capturing Success:

A Visual Celebration











Studimet zbulojnë 604 raste të ngacmimit seksual të fëmijëve gjatë 6 viteve dhe zbrazëtira në mbrojtjen e viktimave

Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve nga ngacmimet seksuale duhet të bëhet më efikas, të koordinohet më mirë dhe të ketë në fokus të plotë nevojat e fëmijës. Kjo u theksua gjatë prezantimit të Studimit të ri mbi Ngacmimin Seksual të Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Statusi, trajtimi institucional dhe sfidat, që u përgatit me mbështetje të projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit ".

> ,Ngacmimi seksual i fëmijëve është një formë dhuneje që shpesh është e vështirë të dallohet. Shpesh ndodh në heshtje, ngaqë viktimat nuk ngrejnë zërin sepse kanë frikë, turp apo nuk kanë besim— sidomos kur dhunuesi është dikush që e kanë të afërt. Megjithatë, kjo çështje nuk ndalon këtu. Kur këto raste iu vihen në dukje institucioneve, trajtimi është shpesh i pjesshëm. Sistemi ka mungesë të koordinimit të nevojshëm dhe nuk ka qasje që fokusohet tek nevojat e fëmijës. Fëmijëve iu duhet mbrojtje institucionale e duhur, në kohë, dhe efektive nga ngacmimi seksual, pra një sistem dhe qasje që ka fëmijën në qendër, theksoi Vaska Bajramovska Mustafa, Këshilltare Shtetërore në Zyrën e Avokatit të Popullit gjatë konferencës për shtyp që u mbajt për të prezantuar studimin.



Me këtë studim trajtohet periudha nga viti 2020 deri në 2025 dhe përbën një nga shqyrtimet më gjithëpërfshirëse të kësaj problematike deri tani, duke analizuar kornizat ligjore të vendit dhe ato ndërkombëtare, praktikat institucionale, të dhënat e disponueshme, dhe sfidat kryesore sistemike, me një fokus të veçantë në kategorinë e ndjeshme të fëmijëve.

Më së shpeshti viktimat janë vajza

Nga gjithsej 508 viktima të dokumentuara në periudhën mes 2020–2024:

- 455 janë vajza (90%)
- 53 janë djem (10%)

Edhepse më shpesh viktimat janë vajzat, ekziston dyshimi që numri i vërtetë i viktimave djem është më i madh, por nuk raportohet për shkak të paragjykimeve. Kjo vlen edhe në terme më të gjera—numri i vërtetë i viktimave në çdo kategori me shumë gjasa është më i lartë nga numri i dokumentuar.
Në vitin 2025, nga gjithsej 96 viktima të regjistruar fëmijë, 88 ishin vajza dhe 8 ishin djem. Krimi më i shpeshtë i regjistruar ishte përdhunimi i fëmijës nën moshën 15 vjeçare me 48 viktima.

Më të prekshmit janë fëmijët nga 11 deri në 15 vjeç

Gjatë periudhës mes vitit 2020–2024:

- 153 viktima kanë moshën 11–13
- 139 viktima kanë moshën 14–15

Kjo do të thotë që mbi 57% e të gjitha viktimave janë fëmijë të moshës mes 11 deri në 15. Kjo analizë poashtu dëshmon që ekzistojnë raste me fëmijë më të vegjël se 10 vjeç, përfshirë një fëmijë nën moshën 3 vjeç, që përbën një alarm serioz për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Zakonisht fëmijët intervistohen disa herë

Edhepse ligji parasheh që fëmija të merret në pyetje vetëm një herë, në praktikë, ata merren në pyetje disa herë – nga policia, qendra për punë sociale, zyra e prokurorisë dhe gjykata. Kjo do të thotë që fëmija ritraumatizohet, që është formë serioze e viktimizimit sekundar.

Fëmijët romë janë sidomos një grup që përfaqësohet shumë

Nga të gjitha rastet e regjistruara, 145 viktima (28%) janë fëmijë romë, që dëshmon lidhje mes ngacmimit seksual dhe faktorëve siç janë varfëria, përjashtimi shoqëror dhe qasja e kufizuar në kujdes institucional.

Duhen ndryshime sistemike

Sipas studimit, ka zbrazëtirë të madhe mes ligjeve dhe zbatimit të tyre prkatik. Disa nga rekomandimet kryesore janë:

- Fëmija të merret në pyetje vetëm një herë
- Zyrat ku merren në pyetje fëmijët të bëhen më të përshtatshme për fëmijët
- Profesionistët e fushës të trajnohen vazhdimisht
- Mbështetje afatgjate psikoanalitike për fëmijët dhe familjet
- Koordinim më i mirë mes institucioneve
- Të prezanohet modeli ,,Barnahus", që i mundëson fëmijës mbështetje ligjore, psikologjike dhe shëndetësore në një vend të vetëm.

Skanoni Kodin QR për studimin e plotë

Në Maqedoninë e Veriut filloi fushata për lobim transparent dhe ligjor


Në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK), filloi fushata ,,Lobimi në Maqedoninë e Veriut". Qëllimi i kësaj fushate është rritja e vetëdijes publike mbi rëndësinë që ka lobimi transparent dhe ligjor dhe informimi dhe edukimi i opinionit mbi rolin që lobimi ka në proceset demokratike.

Nën sllloganin ,,Lobo, ndrysho me transparencë dhe sipas ligjit," kjo fushatë thekson lobimin si një komponent ligjor dhe të rëndësishëm në politikbërjen demokratike gjatë veprimit në mënyrë të rregulluar, etike dhe transparente. Me këtë iniciativë rritet kuptimi i proceseve vendimmarrësve dhe forcohet llogaridhënia dhe besimi tek institucionet.

Si pjesë e kësaj fushate, u organizuan disa diskutime për të rritur vetëdijen mes palëve të sektorit privat, institucioneve në nivele qendrore dhe lokale, OJQ, dhe medieve mbi praktikat transparente dhe etike të lobimit, duke promovuar gjithmonë respektim të ligjeve me të cilat rregullohet fusha e lobimit në Maqedoninë e Veriut. Poashtu, u përpiluan video materiale dhe u bënë të disponueshme për publikun për të shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme konceptin e lobimit, rëndësinë që ka, dhe sfidat që lidhen me transparencën dhe parandalimin e ndikimeve të padëshiruara.

Këto video materiale janë në maqedonisht dhe shqip.

Mësoni më shumë: LINK





Capturing Success:

A Visual Celebration









Autoritetet e linjës së parë për DHBGJ nga Qendrat për Punë Sociale: Nga forcimi i trajtimit të viktimave deri tek kujdesi për tu bërë më të qëndrueshëm

Në kuadër të projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'', u mbajtën dy Trajnime Trajnerësh të njëpasnjëshme për punonjësit e Qendrës për Punë Sociale dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Politikave Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Këto trajnime janë pjesë e angazhimeve të vazhdueshme për të forcuar kapacitetet e autoriteteve të linjës së parë për dhunën në bazë gjinore (DHBGJ) në fushën e të drejtave të njeriut, trajtimit të barabartë dhe etikës profesionale.

Trajnimi i parë – ,,Trajtimi i nevojave të viktimave nga dhuna në bazë gjinore (Niveli bazë)" – kishte në fokus forcimin e aftësive personale dhe profesionale të autoriteteve të linjave të para me theks në qasjen që merr parasysh të drejtat e njeriut, ndjeshmërinë gjinore, dhe parandalimin e viktimizimit dytësor.

,,Gjatë këtij trajnimi kishte shumë momente që të linin me gojë hapur"

Për Grozdanka Milovskin nga QPS Berovë, trajnimi i parë ishte një moment i rëndësishëm në jetën e saj profesionale.

> ,,Kam dashuruar gjithmonë profesionin tim, dhe synoj gjithmonë të mësoj gjëra të reja çdo ditë. Shpesh kap veten time duke menduar, 'E di këtë tashmë.' Por ky trajnim më la gojëhapur. Kjo është diçka e re; diçka që nuk e kam ditur dhe nuk e kam trajtuar më parë."

Ajo theksoi që ishte sidomos me rëndësi që u thellua të kuptuarit e dhunës seksuale dhe ngacmimi seksual online, si dhe koncepti i reagimit në kohë dhe mbrojtja nga viktimizimi dytësor:

> ,,Diçka shumë e rëndësishme për mua ishte sqarimi i 'kujdesit të duhur apo 'due diligence' dhe, sidomos, mbrojtja e viktimave nga viktimizimi dytësor – diçka të cilës jo gjithmonë i kushtohet mjaftueshëm vëmendje nga institucionet.

Standardet ndërkombëtare si mjet praktik

Nebahat Imeri nga QPS Tetovë theksoi zbatueshmërinë praktike të njohurive të marra në raste reale.

> ,,Gjatë punës praktike, kam zbatuar njohuritë e marra gjatë përpilimit dhe arsyetimit të masave mbrojtëse të propozuara për një viktimë të dhunës në familje, duke iu referuar standardeve të parapara në dokumentet CEDAW, si dhe konceptit dhe rrezikut që lidhet me femicidin.”

Kjo qasje i mundësoi asaj të argumentojë në një mënyrë më të strukturuar dhe sistematike mbi nevojën për trajtim urgjent dhe të koordinuar institucional, me theks të qartë në mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së viktimës.

> ,,Ky trajnim kontriboi mjaft për një qasje më efektive, të ndjeshme dhe të barabartë ndaj viktimave, ngaqë na inkurajoi të punojmë në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe standardet e barazisë gjinore dhe të njohim seriozitetin e rrezikut nga femicidi si pasoja përfundimtare e dhunës së vazhdueshme.”

Trajnimi i dytë – ,,Ushtrimi i menaxhimit të stresit dhe parandalimi i sfilitjes (burnout-it)” – u fokusua ne qëndrueshmërinë personale, vetë-rregullimin emocional, vendosjen e kufinjve profesionalë, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë në mjedise të punës që të konsumojnë emocionalisht.



Ndjeshmëri me kufinj profesionalë

Ivana Stojova nga QPS Delçevë theksoi që në trajnimin e parë ka ndjerë ndikimin pozitiv në lidhjen e saj profesionale me viktimat:

> ,,Në praktikë, forcova aftësitë për të dëgjuar në mënyrë aktive, për të komunikuar me ndjeshmëri, dhe qasjen e struktuar për vlerësim të nevojave individuale të përdoruesve të shërbimeve. Tashmë po shoh bashkëpunim më efektiv nga klientët gjatë proceseve të ndihmës dhe mbështetjes profesionale.”

Po kaq domethënës ishte edhe trajnimi i dytë – dedikuar menaxhimit me stresin dhe parandalimit të sfilitjes.

> ,,Ky trajnim më ndihmoi të fitoj vetëdije për nevojën për vetëkujdes dhe vendosje të kufinjve në mënyrë që të ruaj stablitetin profesional.”

Ajo theksoi që teknikat e frymëmarrjes, afirmimet dhe ,,përqafimi i fluturës'', metoda për të qetësuar veten që duke relaksuar sistemin nervor gjatë stresit, tashmë po zbatohen si teknika për stabilizim të shpejtë gjatë punës me raste të vështira.

Poashtu, Nebahat Imeri nga QPS Tetovë theksoi rëndësinë e shëndetit mendor si parakusht thelbësor për ofrimin e shërbimeve cilësore.

> ,,Ky trajnim forcoi më shumë vetëdijen që kisha mbi rëndësinë e vetëmbrojtjes dhe kujdesit për shëndetin mendor si parakusht për efikasitet profesional dhe mbështetje afatgjate të viktimave.”

Puna me viktimat e dhunës sjell me vete barrë të madhe psikologjike. Pjesëmarrësit folën hapur për sfidat e profesionit të tyre.

> ,,Në punën tonë të përditshme gjërat ndodhin shumë shpejt… Por kur stresi bëhet i tepërt ndikon keq në aftësinë që kemi për t'iu përkushtuar detyrave të punës," tha Grozdanka Milovski.

Ky mendin nënvizon porosinë thelbësore të trajnimit të dytë – që kujdesi për veten nuk është luks, por një parakusht për efikasitet profesional dhe mbështetje afatgjate për viktimat. Vetëm një profesionist që është stabil, i vetëdijshëm për kufinjtë që ka, dhe i aftë për të menaxhuar stresin mund të ofrojë mbështetje konsistente, të ndjeshme dhe të cilësisë së lartë për individët që kanë përjetuar dhunë.

Nga vetëdija individuale në kulturë institucionale

Këto dy trajnime bashkë përbëjnë një cikël gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional: nga të kuptuarit e formave të fshehura të dhunës, me zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe qasjes që fokusohet tek viktima, deri tek zhvillimi i qëndrueshmërisë personale dhe parandalimi i sfilitjes.

Siç dëshmohet nga vetë pjesëmarrësit, ndryshimi fillon me vetëdije – por vazhdon me zbatim praktik në punën e përditshme.

Kjo qasje e integruar – që nga mbështetja cilësore për viktimën deri tek kujdesi për profesionistët bart në vete një porosi thelbësore: nuk mund të ketë mbrojtje efektive pa pasur profesionistë stabilë dhe që ndjehen të mbështetur.

Këto trajnime janë pjesë e aktiviteteve më të gjera të projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'', me të cilat synohet forcimi i trajtimit institucional të dhunës me baza gjinore dhe ndërtimi i një kulture profesionale që ka për bazë të drejtat e njeriut, trajtimin e barabartë dhe qëndrueshmëri të shërbimeve.



Konferenca ,,Transparenca si faktor thelbësor për punën e Këshillit të Prokurorëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut”

Bashkë me Këshillin e Prokurorëve Publikë, Projekti organizoi konferencën me titull ,,Transparenca si faktor thelbësor në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Kjo konferencë rezultoi nga aktivitetet e mëparshme pas miratimit të Strategjisë së Komunikimit dhe Transparencës dhe Rregullores mbi mbrojtjen e prokurorëve publikë nga ndikimet e padëshiruara, dy dokumente thelbësore përmes të cilave puna e Këshillit është ngritur një nivel më lartë brenda sektorit të gjyqësorit duke u përputhur me standardet dhe praktikat evropiane.

Në këtë konferencë u trajtuan çështje siç janë Misioni për Mbrojtjen e Pavarësisë së Prokurorëve Publikë dhe Pavarësisë dhe Llogaridhënies-Transparencës si faktor thelbësor në punën e përditshme të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shumë prezantues, përfshirë këtu edhe përfaqësues të Këshillit të Prokurorëve Publikë, Zyrës së Prokurorisë Publike, ekspertë ndërkombëtarë, profesorë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile ndanë qëndrimet dhe këndvështrimet e tyre mbi rolin që ka Këshilli.

Gjatë kësaj konference iu dha vëmendje diskutimeve mbi rëndësinë që ka transparenca në punën e përditshme të Këshillit të Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut si një nga faktorët kryesorë për të rikthyer besimin publik. Kjo ngjarje tërhoqi vëmendjen e opinionit mbi detyrën kryesore që ka Këshilli — ruajtjen e pavarësisë së prokurorëve publikë — si dhe mbi standardet evropiane në fushën e organeve vetëqeverisëse të prokurorisë, me një fokus të veçantë në nevojën për të mbajtur llogaridhënie në të gjitha aktivitetet e Këshillit.

Kjo ishte konferenca e parë organizuar nga Këshilli që nga themelimi i tij, ku morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, dhe nga e gjithë fusha e gjyqësorit, si dhe ekspertë ndërkombëtarë, gjykatës, prokurorë publikë, juristë, dhe profesionistë të fushës së ligjit.





Capturing Success:

A Visual Celebration











Forcimi i gjyqësorit dhe prokurorisë publikë përmes komunikimit transparent

Në prill të vitit 2026, Projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit bashkë me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë mbajti tre trajnime të specializuara mbi aftësitë praktike për komunikim transparent dhe proaktiv me opinionin. Këto ngjarje për rritjen e kapaciteteve u përpiluan për kryetarët e gjyqeve, gjykatësit, prokurorët publikë, zëdhënësit brenda gjyqësorit, dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Gjatë këtyre trajnimeve në fokus ishte mbështetja e zbatimit të strategjive të komunikimit si për gjykatësit ashtu edhe për prokurorët, që kanë për qëllim caktimin e një politike të përbashkët komunikimi, rritjen e transparencës, dhe rritjen e profesionalizimit të relacioneve publike brenda sistemit gjyqësor.

Për të ndërtuar relacione më të mira mes sistemit gjyqësor dhe medieve, në këto ngjarje u mbuluan çështje siç janë rendësia e transparencës, kuptimi i praktikave të gazetarëve, dhe aftësia për të përkthyer termet komplekse juridike në mesazhe të qarta që opinioni publik mund t'i kuptojë lehtë. Poashtu, pjesëmarrësve iu dha mundësia të marrin pjesë në module të veçanta me fokus në navigimin në realitetet e medieve, përpilimin e udhëzuesve mbi informacionet që mund të zbulohen dhe ato që nuk mund të zbulohen, dhe mbi menaxhimin e lëndëve të ndjeshme të profileve të larta.



Ushtrimet praktike përfshinë simulime të komunikimit gjatë krizave, dhënien e deklaratave para kamerave nën presion, dhe strategjitë për rritje të bashkëpunimit mes institucioneve të gjyqësorit dhe medieve. Në këtë trajnim poashtu u trajtua edhe mënyra e komunikimit efektiv brenda vetë institucioneve, duke iu ofruar udhëheqësve mënyra praktike se si të japin lajme të vështira dhe si të trajtojnë mosmarrëveshjet e brendshme.

Modulet e trajnimit u përpiluan dhe u mbajtën në bashkëpunim mes ekipive të ekspertëve ndërkombëtarë dhe lokalë, duke siguruar kështu integrimin e standardeve evropiane me kornizat e veçanta ligjore dhe realitetin praktik të fushës mediatike maqedonase.

Rritja e kapaciteteve që institucionet e gjyqësorit të punojnë në mënyrë transparente dhe me llogaridhënie është një nga qëllimet kryesore që ka Projekti ynë. Duke iu ofruar udhëheqësve të gjyqësorit dhe prokurorisë dhe zëdhënësve mjete komunikimi që janë moderne dhe proaktive, kjo iniciativë ka një rol të rëndësishëm në rritjen dhe mirëmbajtjen e besimit publik, duke ndërtuar kështu komunitet më të hapur dhe më të qëndrueshëm ligjor.





,,Kafe me një qëllim të caktuar” – Angazhimi i burrave për barazi gjinore

Në 24 shkurt 2026, Forumi i të Drejtave të Njeriut mblodhi bashkë palët relevante për të trajtuar barazinë gjinore nga këndvështrimi mashkullor. 50% e pjesëmarrësve ishin burra, duke theksuar kështu rëndësinë që ka angazhimi i meshkujve.

Gjatë këtij diskutimi u trajtua sfida kryesore: barazia përkufizohet shpesh si përgjegjësi e grave.

Bojan Jovanovski, ekspert lokal i çështjeve gjinore theksoi:

> ,,Duhet ndryshuar perspektiva dhe fokusi të drejtohet tek burrat si pjesë e problemit por edhe e zgjidhjes.”

Edhepse burrat përfitojnë nga privilegjet, poashtu edhe dëmtohen nga normat patriarkale — shpesh madje edhe pa e kuptuar. Studimet tregojnë që burrat në shoqëri ku ka barazi më të madhe gjinore kanë më pak gjasa të vuajnë nga depresioni, të vetëvriten apo të kenë vdekje të dhunshme. Nga barazia gjinore përfitojnë të gjithë.

Tim Peute, studies ndërkombëtar për të drejtat e njeriut theksoi zgjidhjet praktike:

> ,,Financimi i iniciativave të reja për ta trajnuar djemtë e rinj si modele shembull për tu ndjekur mund të sjellë një ndryshim real për avancim të barazisë gjinore.”

Në këtë forum poashtu u theksuan edhe tendencat shqetësuese: solidaritet i ulët me viktimat e diskriminimit gjinor dhe rritja e numrit të narrativave anti-gjinore dhe autoritare—sidomos tek djemtë e rinj.

Mesazhi ishte i qartë: angazhimi i meshkujve nuk është thjesht një opsion—është thelbësor për të avancuar barazinë gjinore dhe për të mbrojtur demokracinë.



Capturing Success:

A Visual Celebration









Forcimi i transparencës dhe besimit publik: Mbështetja e KSHPK në ndërtimin e komunikimit strategjik

Komunikimi efektiv është themeli i transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik, sidomos për institucionet që janë në linjën e parë për parandalim dhe luftën kundër korrupsionit. Duke e pasur parasysh këtë, Projekti ynë mbështeti Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK) për përpilim të një Strategjie të gjerë Komunikimi dhe Plani Veprimi, duke shënuar kështu një arritje të rëndësishmë për forcim të mëtejshëm të vizibilitetit të institucionit, besueshmërisë dhe angazhimit publik.

Kjo strategji ofron qasje të strukturuar dhe strategjike për komunikim brenda institucionit por edhe për komunikim të jashtëm, në përputhje me mandatin që ka KSHPK dhe prioritetet e tij institucionale.

Në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësit e KSHPK dhe me stafin e Sekretariatit, projekti ynë mbështeti analizën e thellë të praktikave ekzistuese të komunikimit, identifikimin e palëve kryesore relevante, përpilimin e mesazheve specifike dhe mjeteve të komunikimit. Me Strategjinë e re të Komunikimit vendosen qëllime të qarta, përkufizohen palët e synuara, prezantohen kanale dhe metodologji bashkëkohore të komunikimit. Ajo i mundëson KSHPK që në mënyrë proaktive të informojë dhe të bashkëveprojë me qytetarët, mediet, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një arritje e rëndësishme në këtë proces ishte edhe themelimi i një pozite strategjike për komunikim brenda KSHPK, për të siguruar qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë. U emërua dhe mentorua Komunikuesi Strategjik, duke forcuar kështu kapacitetin e institucionit për të menaxhuar me komunikimet rutinore dhe me ato gjatë krizave. Kjo rriti konsistencën dhe aftësinë për të reaguar gjatë komunikimit me publikun.

,,Me mbështetjen e ofruar me Strategjinë e re, tashmë kemi mjetet dhe mekanizmat për tu angazhuar në mënyrë më efektive me qytetarët dhe palët relevante. Është shumë e rëndësishme për të forcuar rolin si institucion i besueshëm dhe proaktiv në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit", theksoi Kryetari i KSHPK Adem Çuçul.



Plani i Veprimit për Komunikimin forcon operacionalizimin e strategjisë duke theksuar aktivitete konkrete, orare dhe përgjegjësi, me prezantim të mjeteve siç janë mesazhet e standardizuara, protokollet për angazhimin e medieve dhe procedurat për komunikim të brendshëm. Kjo i mundëson KSHPK të prezantojë punën që bën në mënyrë më të strukturuar, transparente dhe të qasshme.

Zëvendës Kryetarja e KSHPK, Sofija Medarska Spasova tha: "Strategjia e Komunikimit na mundëson të informojmë qartë mbi punën që bëjmë, forcon besimin publik dhe demonstron angazhimin që ne marrim për të qenë transparentë dhe llogaridhënës."



Si rezultat i kësaj mbështetjeje, KSHPK forcon qasjen strategjike, transparente për sa i përket komunikimit, që koordinohet mirë si brenda ashtu edhe jashtë. Strategjia e Komunikimit jo vetëm që rrit imazhin publik që ka institucioni, por edhe kontribon për rritje të vetëdijes tek qytetarët, rrit bashkëpunimin me palët relevante dhe rrit besimin në angazhimet kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut.

Forcimi i komunikimit nënkupton edhe forcim të integritetit, llogaridhënies dhe besimit tek institucionet publike.

U mbajtën punëtori për parandalim të dhunës seksuale tek fëmijët

Si pjesë e fushatës ,,1 në 5" që kishte në fokus parandalimin e dhunës seksuale tek fëmijët, u mbajtën 17 sesione trajnimi deri tani ku u trajnuan 346 profesionistë. Me këto sesione u shënua një hap i rëndësishëm drejt forcimit të sistemit për parandalim dhe për njohje të rrezikut në fazat e hershme.

Si rezultat i këtij procesi, stafi profesionist nga kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme — përfshirë këtu pedagogët, psikologët, punonjësit socialë, edukatorët specialë, rehabilitues, mësuesit e arsimit special, terapistët e të folurit, edukatorët, kujdestarët, personeli mjekësor dhe të tjerët — që ishin pjesë e këtyre trajnimeve, vazhduan transferin e njohurive më tutje. Shumë nga pjesëmarrësit tashmë kanë organizuar, dhe disa nga ta për momentin po organizojnë punëtori, duke krijuar kështu mundësi për rritje të vetëdijes, për njohje të shenjave të ngacmimit, dhe për inkurajim të trajtimit në kohë.





Përmes kësaj qasjeje – duke promovuar ndarjen dhe këmbimin e njohurive – ky Projekt kontribon në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin e një komuniteti që është i mirëinformuar dhe vigjilent.

Këto aktivitete do të vazhdojnë edhe në periudhën që vjen, me punëtori të tjera dhe me pjesëmarrës të rinj si dhe në bashkëpunim me prindërit, si pjesë e angazhimeve të vazhdueshme për parandalim dhe mbështetje.



HAXHIEVA ARITA

INTERVISTA

KOORDINATORE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR NË AGJENCINË E MENAXHIMIT ME PRONAT E KONFISKUARA

Ndërtimi i një sistemi modern për menaxhimin me pronat e konfiskuara sipas standardeve të BE-së

Ngjarja ,,Funksionimi operacional i AMPK dhe ndryshimet e reja ligjore", organizuar me mbështetje nga projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit – Komponenti 2", mblodhi bashkë përfaqësues nga institucionet relevante për të diskutuar mbi punën operacionale të Agjencisë për Menaxhim me Pronat e Konfiskuara dhe zhvillimet e fundit ligjore në fushën e rikthimit të pronave dhe menaxhimit të konfiskimeve. Me këtë rast biseduam me Arita Haxhievën, Koordinatore për Bashkëpunimin Ndërkombëtar pranë Agjencisë për Menaxhimin me Pronat e Konfiskuara (AMPK), e cila ndau me ne aktivitetet momentale të kësaj agjencie, sfidat dhe prioritetet për të përafruar punën që bëjnë me standarded e BE-së.

1. **Në një ngjarje mbajtur së fundmi u diskutua sistematizimi i ri. Cilat janë ndryshimet më specifike që sjell ai në organizimin e punës, dhe ç'do të thotë kjo për funksionimin më efikas të Agjenicsë?**

Sistematizimi i ri përbën një reformë thelbësore në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë. U përpilua sipas analizës funksionale dhe është në harmoni të plotë me Ligjin e ri për menaxhim të pronave të konfiskuara dhe mjeteve të ndaluara gjatë procedurave penale dhe civile.

Në veçanti, ky sistematizim i ri bën një ndarje të qartë të përgjegjësive, kompetencave dhe proceseve të punës mes njësive organizative. Për herë të parë, këto procese vendosen në mënyrë të integruar – që nga marrja e pronës, përmes dokumentimit, vlerësimit dhe ruajtjes, deri tek menaxhimi i saj; shitjet dhe qiradhëniet elektronike, ripërdorimi social, si dhe monitorimi financiar.

Struktura e re organizative poashtu prezanton vende të reja pune dhe njësi funksionale që dalin nga detyrimet e reja ligjore, sidomos në fushën e dokumentimit, vlerësimit, ndjekjes, menaxhimit me rrezikun, koordinimin ndër-institucional, dhe bashkëpunimin dhe koordinimin ndërkombëtar.

Kjo nënkupton funksionim më efikas të Agjencisë përmes procesimit më të shpejtë të vendimeve të gjykatave, koordinimit të rritur me gjyqet dhe institucionet e tjera, rritje e transparencës dhe llogaridhënies gjatë menaxhimit me pronat e marra dhe të konfiskuara.

Poashtu, ky sistematizim i ri mundëson përdorim më të mirë të burimeve njerëzore, përkufizim të qartë të përgjegjësive dhe komunikim më efikas të brendshëm, që është shumë i rëndësishëm kur zgjerohen kompetencat dhe kur rritet vëllimi i punës.

Në planin afatgjatë, presim që kjo reformë të kontribojë në forcimin institucional të Agjencisë dhe në mbrojtje më efektive të interesit publik me rezultate të suksesshme në ekzekutimin e konfiskimeve dhe me mesazhe të qarta që krimi nuk ia vlen.

2. **Zgjidhjet e reja ligjore janë në qendër të këtyre reformave. Cili nga këto segmente sipas jush do të ndikojë më së shumti në efikasitetin dhe transparencën e menaxhimit me pronat e konfiskuara?**

Ligji i ri jep bazat për një sistem modern, funksional dhe më të qëndrueshëm për menaxhim me pronat e konfiskuara, në përputhje me standardet dhe rekomandimet evropiane, por edhe me nevojat e vërteta që dalin nga praktika.



Besoj që një nga zgjidhjet më të rëndësishme ligjore është prezantimi i një sistemi të përkufizuar qartë dhe të integruar për menaxhim me pronat e konfiskuara, me kompetenca të qarta dhe me procese dhe mekanizma që mund të monitorohen dhe ndiqen.

Ligji i ri thekson nevojën për regjistër elektronik, në përputhje me Direktivën e re të BE-së. Kjo siguron që dokumentimi të bëhet më mirë, më transparent dhe të ketë kontroll që nga momenti kur pronat konfiskohen përkohësisht. Secila lëndë do të ketë proces të përkufizuar qartë, që do të mbulojë marrjen, vlerësimin, lokacionin, menaxhimin dhe realizimin përfundimtar. Kjo qasje ul ndjeshëm rreziqet nga mosefikasiteti, humbja e vlerës dhe monitorimit të pamjaftueshëm.

Është poashtu domethënës fakti që ky ligj ofron koordinim më të mirë ndër-institucional dhe këmbim të dhënash mes të gjitha institucioneve kompetente, që është thelbësore për procesim më të shpejtë të vendimeve gjyqësore dhe për menaxhim më efikas me pronat.

Nga këndvështrimi i transparencës, janë poashtu shumë të rëndësishme rritja e dokumentimit elektronik dhe mekanizmave për monitorim të pronave dhe procedurave, si dhe sistemit elektronik të shitjeve. Ankandet publike elektronike i mundësojnë çdo qytetari të ndjekë përparimin e shitjes përmes faqes së internetit të Agjencisë, që kontribon për llogaridhënie më të madhe, kontroll më të mirë dhe besim më të madh tek institucionet.

Poashtu, ky ligj sjell modernizim në fushën e shitjeve elektronike, menaxhimit me prona të marra përkohësisht, ripërdorim social, si dhe prezantimin e mekanizmave shtesë për parandalim të keqpërdorimit procedural.

3. **Siç thatë, ky ligj parasheh edhe bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet zakonisht Agjencia, dhe si funksionon kjo në praktikë?**

Po, menaxhimi me pronat e marra dhe të konfiskuara është një proces kompleks dhe për nga natyra që ka kërkon koordinim të vazhdueshëm mes disa institucioneve – gjykatave, zyrave të prokurorisë publike, Ministrisë së Brendshme, zbatuesit e ligjit, organeve të inspeksionit, Agjencisë së Kadastrit, Bankës Kombëtare, Regjistrit Qendror, Drejtorisë së Doganave, institucioneve financiare dhe autoritete të tjera.

Një nga sfidat më të zakonshme është këmbimi në kohë i informacioneve dhe dokumenteve, sidomos në rastet kur procedurat janë komplekse dhe kur janë në pyetje lloje të ndryshme të pronave.

Në praktikë, është shumë me rëndësi që të dorëzohen në kohë vendimet e fundit, të regjistrohen siç duhet dhe të koordinohet shpejt kapja e tyre, ruajtja dhe menaxhimi i mëtejshëm. Një segment që është sidomos i ndjeshëm është edhe sigurimi i monitorim dhe ruajtja e vlerës së pronës deri në realizimin final.

Prandaj, brenda kornizës së procesit të reformave dhe me mbështetje të Projektit IPA të BE-së ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", një theks i veçantë i jepet forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, standardizimit të procedurave dhe digjitalizimi i proceseve dhe dokumentimit. Sistematizimi i ri dhe rregullimi i ri organizativ parashohin pika më të qarta të kontaktit, koordinim më të mirë mes sektorëve të ndryshëm dhe komunikim më efektiv me institucionet e jashtme. Në praktikë kjo do të thotë përshpejtim i aktiviteteve, rritje e transparencës dhe menaxhim më efikas me pronat e konfiskuara

4. **Ky projekt mbështet punën e Agjencisë. Cilat aktivitete apo mjete kanë kontribuar që të rritet cilësia e punës suaj?**

Projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" ka pasur një rol të rëndësishëm në forcimin institucional dhe zhvillimin e Agjencisë. Duhet pasur parasysh që kjo Agjenci është themeluar në vitin 2009, dhe për vite me radhë kapacitetet nuk kanë pasur nivelet e dëshiruara. Niveli i stafit ishte rreth 40%, dhe institucioni nuk njihej mjaftueshëm në aspektin institucional dhe kompetencat që kishte nuk njiheshin mjaftueshëm nga institucionet e tjera.

Pikërisht përmes mbështetjes së projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' u bë planifikimi dhe identifikimi i nevojave të Agjencisë. Më këtë mbështetje u bë analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes së Agjencisë, që përbën një dokument strategjik dhe udhëzues për zhvillim të mëtejshëm.



Poashtu ofron një themel për fillim të aktiviteteve brenda agjendës së reformave, sidomos për sa i përket plotësimit të numrit të stafit brenda institucionit—një proces që për momentin është në fazë të avancuar të zbatimit. Si rezultat i mbështetjes së marrë, u përpilua Rregullorja e re për Organizim të Brendshëm dhe Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës, në përputhje të plotë me Ligjin për menaxhim me pronat e konfiskuara, procedimet dhe mjetet e konfiskuara në procedurat penale dhe të shkeljeve.

Kjo Agjenci vepron si institucioni kompetent për zbatim të vendimeve përfundimtare të gjyqit, por nuk është pjesë e hetimeve financiare. Në praktikë, shpesh kemi sfida lidhur me mos-zbatueshmërinë apo paqartësinë e vendimeve të gjyqeve. Edhepse aktet e Agjencisë bazohen në gjykimet finale, ajo shpesh bën hetime shtesë operative për pronat për të siguruar zbatim efektiv të vendimit. Këto hetime shtesë janë sfida më e madhe që kemi në punën tonë praktike.

Përmes punëtorive, trajnimeve dhe përfshirjes së Agjencisë në nivel ndërinstitucional, zbrazëtirat praktike brenda sistemit u plotësuan në masë të madhe. E themi shpesh që për të pasur konfiskim të mirë, na duhet një vendim gjyqësor i mirë. Sot, falë mbështetjes së këtij Projekti, bashkëpunimi ndërinstitucional është forcuar mjaft dhe roli i Agjencisë sonë brenda sistemit kuptohet më mirë. Poashtu, me mbështetjen që ka dhënë projekti u përpiluan akte nënligjore në përputhje me standarded e BE-së, që mundësuan standardizim më të madh, procedura të qarta dhe trajtim më efikas. Është poashtu me rëndësi të thuhet që përmes këtyre aktiviteteve, Agjencia është bërë më e dukshme – jo vetëm në nivel të vendit po edhe në nivel ndërkombëtar, si një institucion që vepron në mënyrë aktive për të rritur cilësinë e sistemit për menaxhim me pronat e konfiskuara. Gjatë viteve mbështetja nga ky projekt nuk ka qenë vetëm teknike, por një nxitës i vërtetë i reformave, forcimit institucional dhe profesinalizim të Agjencisë.

5. **Si do të dukej për ju një ,,sistem i suksesshëm'' për menaxhim me pronat e konfiskuara në të ardhmen – cilat rezultate do të dëshmonin që reformat kanë pasur efekt real?**

Për mua, një sistem i suksesshëm për menaxhim me pronat e konfiskuara është një sistem efikas, transparent, funksional dhe në përputhje të plotë me standardet evropiane, por poashtu edhe i zbatueshëm në praktikë brenda kontekstit tonë institucional.

Kjo fillimisht do të thotë që vendimet e gjyqit janë të zbatueshmë në mënyrë të shpejtë, të qartë dhe të plotë, dhe që Agjencia vepron sipas tyre shpejt dhe në mënyrë efikase, pa pengesa administrative dhe mospajtueshmëri institucionale. Një sistem i suksesshëm nënkupton poashtu mundësi të plotë për të ndjekur pronat – që nga momenti i ndalesës momentale, drejt vlerësimit, ruajtjes dhe menaxhimit, deri në shitjen e fundit apo ndonjë formë tjetër realizimi. Kjo është arsyeja se pse regjistri elektronik, dixhitalizimi dhe procedurat e standardizuara kanë rëndësi të madhe.

Poashtu, një nga treguesit më të rëndësishëm të suksesit do të ishte bashkëpunimi i forcuar ndërinstitucional dhe të kuptuarit e qartë të rolit që ka çdo institucion në këtë proces. Sot, tashmë kemi zhvillime pozitive në këtë drejtim, por qëllimi është të ndërtohet një sistem ku institucionet do të funksionojnë në mënyrë të koordinuar dhe në kohë.

Poashtu, një sistem i suksesshëm nënkupton që ruhet vlera e pronës, ulen rreziqet e keqpërdorimit dhe sigurohet transparencë më e madhe dhe besimi publik në institucione. Qytetarët duhet të shohin që ka një sistem të qartë, të kontrolluar dhe llogaridhënës për menaxhim me pronat e konfiskuara.

Unë besoj që një tregues thelbësor i suksesit do të ishte zbatimi i sistemit ‘’historiati i regjistrave (track record)” dhe regjistrit ndërinstitucional. Këto mjete do të na mundësonin të mbledhim tregues të vërtetë statistikorë lidhur me efektet e konfiskimit dhe menaxhimit të pronave. Në qoftë se me këto mekanizma e dëshmojmë që ulet numri i krimeve, ofrojmë prova të qarta që sistemi punon në mënyrë efektive.

Porosia duhet të jetë e qartë – krimi nuk ia vlen. Thelbi i konfiskimit është t’iu hiqet forca ekonomike që është fituar duke bërë krime dhe të dëshmohet që askush nuk mund të përfitojë nga pronat e fituara në mënyrë të jashtëligjshme. Për mua, një tregues i vërtetë që reformat janë efektive do të jetë momenti kur Agjencia të funksionojë si një institucion i pajisur në tërësi, profesional dhe që njihet institucionalisht, me procedura të qarta, me profesionistë të trajnuar dhe me mekanizma moderne për menaxhim, që njihet si partner i besuar si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.

MAJ - GUSHT 2026

KALENDARI NGJARJET E ARDHSHME

6 MAJ

Konferenca: Transparenca si faktor thelbësor në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë

Komponenti 1

1-2 QERSHOR

Punëtoria për analizat dhe procesimin e të dhënave

Komponenti 3

17 - 19 QERSHOR

Trajnimi “Forcimi i përgjigjes së policisë ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (me fokus tek viktima, me qasje që merr për bazë të drejtat e njeriut dhe me qasje multisektoriale)”

Komponenti 4

18 - 22 MAJ

Punëtoria Lufta kundër trafikimit ilegal të drogës Sesioni III

Komponenti 2

16 - 18 QERSHOR

Vizitë studimore në MPB Lublanë për Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Policor (SBNP)

Komponenti 2

20 -21 maj

Prezantim dhe diskutim mbi metodologjinë e propozuar për realizim të vizitave të Avokatit të Popullit në fushën e luftës kundër trafikimit të njerëzve

Komponenti 4

IMPRINT

Botues: Ludwig Boltzmann Gesellschaft - Instituti i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut (LBI-GMR), Vjenë, në kuadër të Projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", Shkup
Redaktoi: Kristina Vesiq
Lektura: Ane Petrushevska
Periudha e raportimit: 8 shkurt - 7 maj 2026
Data: 7 maj 2026

Financuar nga Bashkimi Evropian